



Pranuar / Dorezuar Priljevoj / Prodato Received / Delivery	25.09.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicitna Quantity
SKIMSHK	6246/2023		1/7



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.Nr.1056/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Jeton Koca dhe Eshref Shabani, anëtarë; me Ardita Perçuku Shyti, Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.Nr.1056/2023, të datës 03.08.2023, të parashtruar nga ankuesi në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me Nenin 6, paragrafin 1; Nenin 16, paragrafi 3 dhe Nenin 18, paragrafin 1 nën paragrafin 1.1' të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 25.09.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

- I. *Refuzohet si e pabazuar* ankesa me numër A.Nr.1056/2023, e datës 03.08.2023, e parashtruar nga ankuesi
- II. *Mbetet në fuqi* Vendimi i datës 26.07.2023, i Komisionit të Vlerësimit për Ngritje në Detyrë, të Komunës së Prishtinës, për refuzimin e ankesës së ankuesit kundër testimit me shkrim, Vendimi i datës 27.07.2023, i Komisionit të Vlerësimit për Ngritje në Detyrë, të Komunës së Prishtinës, për refuzimin e ankesës së ankuesit kundër vlerësimit në intervistën me gojë si dhe Njoftimi i datës 08.08.2023, i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, për shpalljen e kandidatit të suksesshëm.

A r s y e t i m

Ankuesi (tutje vetëm ankuesi), më datë 03.08.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjë A.Nr.1056/2023A, kundër Njoftimit të datës 14.07.202, të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës si dhe Vendimit të datës 26.07.2023 të Komisionit për Ngritje në Detyrë lidhur me refuzimin e ankesës së ankuesit kundër vlerësimit të testit me shkrim, për shkak të shkeljes së Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e

Përgjithshme Administrative, Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe mos vërtetimit të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*më tej Këshilli*), bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 14.08.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Prishtinës, ndërsa, kjo e fundit, më datë 18.08.2023, ka përcjell shkresat lidhur me çështjen në procedurë të vendosjes.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, bazuar në autorizimet ligjore sipas nenit 17, paragrafi 2, të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin me numër protokollit 6037/2023, të datës 08.09.2023, ka vazhduar afatin për vendimmarrje edhe për 10 ditë pune, lidhur me ankesën A.nr.1056/2023, të datës 03.08.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 1056/2023 të datës 03.08.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin e datës 14.07.2023 nga Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Prishtinës; Ankesën e ankuesit të datës 21.07.2023 e parashtruar tek Komuna e Prishtinës; Vendimin e datës 26.07.2023 nga Komisioni për Ngritje në Detyrë; Komunikimet elektronike të datës 14.03.2023, 15.02.2023, 10.02.2023, 07.02.2023, 21.07.2023, 06.07.2023, 01.03.2023, 28.02.2023 përmes e-maileve ndërmjet Shoqatës Sindikale SPPAKP, ankuesit si dhe Komunës së Prishtinës lidhur me vëzhgimin e procedurës së rekrutimit në fjalë; Vendimin me numër A.nr.845/2021 të datës 17.11.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 14.08.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 18.08.2023 nga Komuna e Prishtinës së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Konkursin e datës 02.02.2023 me numër reference RN00010904; Vendimin e datës 31.05.2023 lidhur me themelimin e Komisionit të vlerësimit për ngritje në detyrë; Listën e aplikantëve të gjeneruar tek SIMBNJ të aprovuar; Njoftimin e datës 03.05.2023 lidhur me listën e ngushtë të kandidatëve; Njoftimin e datës 15.05.2023 lidhur me listën e ngushtë të kandidatëve pas shqyrtimit të ankesave; Njoftimin e datës 08.08.2023 lidhur me përzgjedhjen e kandidatit të suksesshëm pas shqyrtimit të ankesave; Njoftimin e datës 14.07.2023 lidhur me shpalljen e kandidatit të suksesshëm; Diplomën e ankuesit me numër Nr.564 të datës 15.06.2003 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës-Fakulteti Ekonomik; Certifikatat e ankuesit dhe atë: Certifikatën e datës 04.05.2015 e lëshuar nga GFA; Certifikatën e datës 12.03.2012 e lëshuar nga Ministria e Financave; Certifikatën e lëshuar nga Ministria e Financave-CIPFA; Certifikatën mbi dënimet penale të datës 21.02.2023; Licencën e ankuesit me numër No.120 të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave; Certifikatën e datës 05.10.2011 nga Ministria e Financave; Vërtetimin e punësimit për ankuesin të datës 12.01.2023 nga Zyra Kombëtare e Auditimit; Vërtetimin e punësimit të datës 11.01.2023 nga Komuna e Prishtinës; Referencën e datës 02.03.2004 nga ankuesin; Referencën e datës 20.01.2015 nga ankuesin; Referencën e datës 29.07.2015 nga K.Z për ankuesin; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Formularët për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 30.12.2022 dhe 28.01.2021 për ankuesin; Akt emërimit të ankuesit me numër 01 nr.112-933 të datës 01.02.2019 së bashku me formularin mbi përkrahimin dhe detyrën të punës; Formularët e intervistës me gojë nga anëtarët e komisionit të datës 07.07.2023 për kandidatin Vendimin me numër 14-117/01-0018330/19, të datës 30.01.2019, për sistemimin e ankuesit; Kërkesën e ankuesit të datës 24.01.2019 me numër 14-117/01-0018339/19 lidhur me ri sistematizimin; Diplomën e kandidatit O.B me numër 566/15 të datës 24.06.2015 nga Kolegji AAB;

Diplomën e kandidatit me numër 666/10 të datës 14.10.2010 nga Kolegji AAB; Diplomën me numër 1146 të datës 18.06.2007 nga Gjumnazi "Eqrem Qabej"-Vushtrri; Certifikatën e kandidatit si në vijim dhe atë: Certifikatën nga KAF për datat e trajnimit 25-29.11.2022; Certifikatën e datës 05.06.2019 me numër 274/2019 nga Ministria e Financave; Certifikatën nga BIP për periudhën 18-19.09.2015; Certifikatën nga FLSA për periudhën 12-15.12.2014; Certifikatën nga DEMOS; Kontratën për marrëveshjen mbi shërbimet e veçanta me numër 01 Nr.119 245099 të datës 24.10.2016; Akt emërimin me numër 01-112-1080 të datës 24.08.2016; Vendimin për caktimin e ushtruesit të detyrës me numër 14-112/02-276596/22 të datës 28.12.2022; Kopjen e letërnjoftimit për Formularin për kërkesë apo ankesë të datës 29.12.2022; Formularët për vlerësimin e rezultateve në punës të datës 29.12.2022 dhe 06.12.2021; Vërtetimin e punësimit me numër Nr.016, të datës 13.02.2023; Vërtetimin e punësimit me Nr.002, të datës 11.01.2023, për ankuesin; Njoftimin e datës 28.12.2022 nga Komuna e Prishtinës; Konkursin e datës 23.11.2022 me numër reference RN00009281; Vendimin e datës 27.07.2023 të Komisionit për ngritje në detyrë, Vendimin e datës 27.07.2023 të Komisionit për ngritje në detyrë; Vendimin e datës 26.07.2023 të Komisionit për ngritjen në detyrë; Renditjen përfundimtare të kandidatëve të datës 08.08.2023; Vërtetimin me numër 016 të datës 13.02.2023 mbi masën disiplinore për kandidatin Vërtetimin me numër 021 të datës 21.02.2023 mbi masën disiplinore për ankuesin; Certifikatën mbi dënimet penale për të datës 03.05.2023; Vendimin me numër protokolli 6037/2023 të datës 08.09.2023, lidhur me vazhdimin e afatit të ankesës së ankuesit në Këshill.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankuesit *është e pa bazuar, sepse:*

Nga administrimi i provave materiale të parashtruara nga palët në procedurë, Kolegji i Këshillit ka gjetur se Komuna e Prishtinës me datë 02.02.2023, ka publikuar në sistem qendror elektronik (SIMBNJ), Konkursin për Ngritje (avancim) në Detyrë, me numër reference RN00010904, për pozitën e punës "Udhëheqës i Auditimit të Brendshëm", e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, duke u përfshirë në të gjitha fazat e vlerësimit.

Tutje, në bazë të Njoftimit të datës 14.07.2023 (i gjeneruar nga SIMBNJ), kandidati i suksesshëm për këtë procedurë të rekrutimit është përzgjedhur me gjithsejtë 92.76 pikë.

Ankuesi me datë 21.07.2023, ka parashtruar ankesë pranë Komisionit të Vlerësimit për Ngritje në detyrë (këtu e tutje KVND-së), ndërsa, KVND-ja me vendimin e datës 26.07.2023 (pa numër vendimi dhe pa numër protokolli), ka refuzuar ankesën e ankuesit lidhur me kundërshtimin e testit me shkrim, me Vendimin e datës 27.07.2023 (pa numër vendimi dhe pa numër protokolli), ka aprovuar ankesën e ankuesit lidhur me vlerësimin e jetëshkrimit të ankuesit, kurse, me Vendimin e datës 27.07.2023 (pa numër vendimi dhe pa numër protokolli) ka refuzuar ankesën e ankuesit lidhur me kundërshtimin e vlerësimit sipas intervistës me gojë.

Pas shterimit të ankesave të brendshme, KVND-ja me datë 08.08.2023, ka përgatitur listën përfundimtare të vlerësimit të kandidateve, me ç'rast kandidati është vlerësuar me 92.76 pikë, duke u renditur si kandidati i parë, kurse ankuesi është vlerësuar me gjithsejtë 71.67 pikë, duke u renditur si kandidati i dytë. Në bazë të vlerësimit përfundimtar të KVND-së, Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, më datë 08.08.2023, ka publikuar njoftimin e shpalljes së kandidatit fitues rrejdhimisht kandidati është shpallur si kandidat i

suksesshëm për pozitën e shpallur të Udhëheqësit të Auditimit të Brendshëm, në Komunën e Prishtinës.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Komuna e Prishtinës ka shkelur dispozitat e nenit 64, paragrafit 1, të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, sepse, shpallja e konkursit për pozitën Udhëheqës i Auditimit të Brendshëm është shpallur pa u anuluar procedura e rekrutimit të brendshëm për lëvizje paralele e datës 19.07.2021, dhe se është tejkaluar afati ligjor me rastin shpalljes së konkursit për ngritje në detyrë. Me tej, ankuesi pretendon se anëtarët e Komisionit të Vlerësimit nuk kanë qenë nga pozitat adekuate dhe së të njëjtit nuk kanë përvojë dhe njohuri adekuate për detyrat dhe aktivitetet e auditimit të brendshëm, sepse pyetjet e testit me shkrim nuk ishin adekuate për testim meritore dhe se Komisioni i Vlerësimit nuk ka bërë vlerësim të drejtë të CV-së pasi që nga 20 pikë, është vlerësuar me gjithsejtë 12.67 pikë, ndërsa ankuesi ka ofruar dëshmi të mjaftueshme lidhur me përvojën e punës, edukimin dhe trajnimet. Me tej shton se Vendimi i Komisionit të Vlerësimit lidhur me refuzimin e pretendimit për testin me shkrim, është në kundërshtim me nenin 48, paragrafin 2, të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA-së) pasi që i njëjti nuk përmban elementet e detyrueshme të aktit administrativ. Për më tepër sipas ankuesit Komuna e Prishtinës, përkundër kërkesës së Shoqatës Sindikale të Komunës së Prishtinës, nuk kishte njoftuar këtë të fundit lidhur me kohën dhe datën e intervistës, ashtu siç përcaktohet me nenin 19 të Rregullores (QKR) Nr.16/2022, dhe në fund thekson se Komuna e Prishtinës më presion dhe në mënyrë të kundërligjshme e ka degraduar ankuesin, pasi që i njëjti ka mbajtur pozitën e Udhëheqësit të Auditimit të Brendshëm. Kërkon nga Këshilli që ta aprovoj ankesën e tij si të bazuar, ta anuloj Njoftimin e datës 14.07.2023 të Komunës së Prishtinës si dhe Vendimin e Komisionit të Vlerësimit për Ngritjen në Detyrë si dhe konkursin e datës 02.02.2023 lidhur me pozitën në fjalë, si dhe ta obligoj Kryetarin e Komunës së Prishtinës që procedurën e rekrutimit për këtë pozitë ta anuloj dhe të njëjtën ta kthej në pikën zero, duke e kthyer ankuesin në pozitën e tij të mëparshme si Udhëheqës i Auditimit të Brendshëm në Komunën e Prishtinës.

Kolegji i Këshillit në kontekst të shqyrtimit të pretendimeve ankimore fillimisht analizoj Konkursin me numër të referencës RN00010904, për ngritje në detyrë lidhur me pozitën "Udhëheqës i Auditimit të Brendshëm" në Komunën e Prishtinës, dhe për pasojë konstatoi se kriteret formale për pozitën përkatëse të punës kanë qenë: **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to; Master apo Fakulteti Ekonomik/Juridik; Përvoja e punës e kërkuar:* *Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale. Kualifikime të posaçme formale:* *të jetë i certifikuar me certifikatë të auditorit të brendshëm në spektroren publik, e lëshuar nga Ministria e Financave ose certifikatë për auditorë të brendshëm në sektorin publik nga ndonjë institucion relevant ndërkombëtar apo vendor në pajtueshmëri me kriteret e nxjerra nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve.*

Lidhur me pretendimin ankimor se shpallja e konkursit për ngritje në detyrë për pozitën Udhëheqës i Auditimit të Brendshëm, është bërë pa u anuluar procedura e rekrutimit të brendshëm për lëvizje paralele e datës 19.07.2021 dhe jashtë afatit ligjor, Kolegji analizoj dispozitat e nenit 39 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët publikë më të cilën është përcaktuar se: 1. Nëse një pozitë e lirë e kategorisë së ulët apo e mesme drejtuese nuk është plotësuar sipas nenit 38 të këtij ligji, ajo hapet për procedurën e ngritjes në detyrë. 2. Mund të aplikojnë për ngritje në detyrë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, vetëm nëpunësit civilë të një kategorie më të ulët, në marrëdhënie pune në të njëjtin apo në çdo institucion tjetër të Shërbimit Civil, nëse plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë. Në procedurën e ngritjes në detyrë në kategorinë e ulët drejtuese mund të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të kategorisë profesionale të konfirmuar sipas nenit 37 të këtij ligji. 3. Ngritja në detyrë realizohet



nëpërmjet një procedure konkurruese të organizuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore të institucionit, që ka pozitën e lirë. 4. Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë nen, për procedurën e ngritjes në detyrë zbatohen dispozitat e paragrafëve 4 deri 9 të nenit 34 të këtij ligji.... si dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht Nenin 52 paragrafi 1 ku parashihet: 1.Në rastet kur një pozitë e lirë në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese nuk plotësohet nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë, pozita hapet për të plotësuar nëpërmjet ngritjes në detyrë...” andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji konston se nuk ka mbështetje një pretendim i tillë ankimor, sepse, Komuna e Prishtinës ka respektuar dispozitat ligjore si me sipër, rrejdhimisht lidhur me plotësimin e pozitës së Udhëheqësit të Auditimit të Brendshëm, Komuna e Prishtinës kishte shpallur fillimisht procedurën e lëvizjes brenda kategorisë sipas Konkursit me numër reference: RN00009281, të datës 23.11.2022, e cila procedurë kishte përfunduar me Njoftimin e datës 28.12.2022, të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës pa kandidatë fitues, pasi që nuk kishte aplikuar asnjë kandidat, ndërsa, më datë 02.02.2023, Komuna e Prishtinës ka shpallur konkursin me numër reference RN00010904 për Ngritje (avancim) në detyrë. Në këtë kontekst, po ashtu Kolegji thekson faktin se sipas kuadrit ligjor të lartcekur nuk përcaktohet ndonjë afat i detyrueshëm ligjor lidhur me shpalljen e Konkursit për ngritje në detyrë, pas përfundimit të procedurës së lëvizjes në kategori, ashtu siç pretendohet nga ankuesi në ankesën e tij të parashtruar në Këshill.

Përkitazi me pretendimin ankimor të ankuesit se i njëjti me presion dhe në mënyrë të kundërligjshme është degraduar nga pozita e Udhëheqësit të Auditimit të Brendshëm, Kolegji i Këshillit në provat e lëndës ka gjetur se ankuesi përmes parashtresës me numër protokolli 14-117/01-0018330/19, të datës 24.01.2019, drejtuar Kryetarit të Komunës së Prishtinës, ka kërkuar që nga pozita e Udhëheqësit të Auditimit të Brendshëm, të sistemohet në pozitën e auditorit të brendshëm, me arsyetimin se për shkak të gjendjes shëndetësore janë paraqitur probleme në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi të drejtorit të njesisë së auditimit, e mbi bazën e kësaj Kryetari i Komunës së Prishtinës më Vendimin me numër 14-117/01-0018330/19 të datës 30.01.2019, ka bërë sistemimin e ankuesit në pozitën e auditorit të brendshëm në kuadër të Kabinetit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, andaj, nisur nga gjendja e këtyre fakteve dhe duke qenë se ankuesi me asnjë shkresë nuk ka arrit të dëshmoj se i njëjti ka kundërshtuar me mjete juridike vendimin për sistemim të datës 30.01.2019, rezulton së është i paqëndrueshëm pretendimi ankimor i ankuesit, se i njëjti në mënyrë të kundërligjshme është degraduar nga pozita e Udhëheqësit të Auditorit të Brendshëm.

Referuar pretendimit ankimor se anëtarët e Komisionit të Vlerësimit, nuk kanë qenë nga pozitat adekuate dhe së të njëjtit nuk kanë përvojë dhe njohuri adekuate për detyrat dhe aktivitetet e auditimit të brendshëm, Kolegji ka analizuar vendimin me numër 14-020/04-110725/23, të datës 31.05.2023 për themelimin e Komisionit të Vlerësimit për Ngritje në detyrë lidhur me Konkursin me numër referencë RN00010904, nga dhe ka konstatuar së përbërja e Komisionit të Vlerësimit është në pajtim me dispozitat e nenit 59 paragrafi 3 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me të cilin është përcaktuar se: 3.KVND ka në përbërje këta anëtarë: 3.1. një përfaqësues i Njesisë Përgjegjëse (DMZP-ja për institucionet e administratës shtetërore apo Njësia e Burimeve Njerëzore të Institucionit për institucionet e tjera shtetërore) i specializuar në teknikat e përzgjedhjes. 3.2. një përfaqësues nga NJBNJ e vetë institucionit që ka pozitën e lirë; 3.3. një nëpunës civil i kategorisë të lartë drejtuese të vetë institucionit apo të një institucioni tjetër të shërbimit civil, me përgatitje të veçantë në procedurat e përzgjedhjes. Ndërsa, lidhur me pretendimet ankimore përkitazi me vlerësimin e ankuesit në fazat e kësaj procedure të ngritjes në detyrë, Kolegji bazuar në shkresat

e lëndës ka gjetur se ankuesi është vlerësuar në testin me shkrim me gjithsejtë 49 pikë, në jetëshkrim me gjithsej 14 pikë nga maksimumi i 20 pikëve, ndërsa, në intervistën me gojë 8.64 pikë nga maksimumi i 10 pikëve. Rrjedhimisht, ankuesi nuk ka ofruar dëshmi të cilat argumentojnë se se Komisioni i Vlerësimit ka bërë vlerësim jo të drejtë të ankuesit, andaj në këtë drejtim edhe ky pretendim ankimor nuk ka mbështetje.

Po ashtu, Kolegji konstaton se është i pabazuar pretendimi ankimor i ankuesit, se në procedurën e vlerësimit të intervistës me gojë, nuk është ftuar Shoqata Sindikale e Komunës së Prishtinës, për faktin se bazuar në provat e lëndës rrjedhë së me datë 06.07.2022, Zëvendësuesi i Menaxherit të Personelit në Komunën e Prishtinës, përmes e-mailit zyrtar ka njoftuar Shoqatën Sindikale të Komunës së Prishtinës lidhur me datën, vendin dhe kohën e mbajtjes së intervistës me gojë.


Referuar pretendimit ankimor, se vendimet e Komisionit të Vlerësimit të nxjerra në procedurë të ankesës, janë në kundërshtim me nenin 48 të LPPA-së, Kolegji nga shqyrtimi i vendimit të datës 26.07.2023 (pa numër vendimi dhe pa numër protokolli), lidhur me refuzimin e ankesës së ankuesit përkritazi me vlerësimin e testit me shkrim, dhe Vendimit të datës 27.07.2023 (pa numër vendimi dhe pa numër protokolli), lidhur me refuzimin e ankesës së ankuesit përkritazi me vlerësimin sipas intervistës me gojë, ka gjetur se vendimet në fjalë përmbajnë pjesën hyrëse, dispozitivin dhe arsyetimin e shkurtër, por të njëjtit nuk përmbajnë këshillë juridike, mirëpo, duke qenë se ankuesi brenda afatit ligjor ka pashtruar ankesë në Këshill, Kolegji vlerëson se një e meteeë tillë ligjore nuk ka efekt juridik relevant në raport me ligjshmërinë procedurale dhe materiale të procedurës së ngritjes në detyrë për pozitën e Udhëheqësit të Auditimit të brendshëm në Komunën e Prishtinës.

Në kuptim të plotësimit të kriterëve të përgjithshme formale, Kolegji i Këshillit nga analizimi i dokumentacionit të aplikimit, ka gjetur se kandidati i përzgjedhur ka dorëzuar: Diplomën me numër Nr.666/10, të datës 14.10.2010, të lëshuar nga Kolegji AAB-Riinvest në Prishtinë, me të cilën dëshkohet se i njëjti me datën 14.09.2010 ka përfunduar studimet themelore universitare në programin banka, financa dhe kontabilitet dhe me këtë rast ka marrë titullin Baçelor (BA) në banka, financa dhe kontabilitet, Diplomën me numër Nr.566/15 të datës 24.06.2015 të lëshuar nga Kolegji AAB-Riinvest në Prishtinë, me të cilën dëshkohet se i njëjti me datën 24.06.2015 ka përfunduar studimet master në programin tregjet financiare dhe bankat. Lidhur me kriterin e kualifikimeve të posaçme ka ofruar Certifikatën me numër 274/2019, të datës 05.06.2019, të lëshuar nga Ministria e Financave, sipas së cilës dëshkohet se ka përfunduar me sukses kërkesat e programit kombëtar për trajnimin e auditorëve të brendshëm të sektorit publik, ndërsa, ndërlidhur me përvojën e punës i njëjti ka dorëzuar: Marrëveshjen për shërbime të veçanta me numër 01 Nr.119 245099, të datës 24.10.2014, sipas të cilës rezulton së i njëjti ka punuar në Komunë e Prishtinës në cilësinë e Ekspertit për qeverisje të mirë, në kuadër të Kabinetit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, për periudhën nga data 20.10.2014-19.04.2015; si dhe Akt emërimin me numër 01-112-1080, të datës 24.08.2016, me të cilin dëshkohet se i njëjti ka ushtruar pozitën e Auditorit të brendshëm në Kabinetin e Kryetarit të Komunës së Prishtinës. Kështu që mbi ekzistimin e këtyre fakteve konstatohet se kandidati ka plotësuar kriteret formale për pozitën e Udhëheqësit të Auditimit të Brendshëm dhe duke qenë së i njëjti është vlerësuar si kandidati me më shumë pikë më gjithsej 92.76, Kolegji konstaton së KVND-ja ka vepruar në pajtimin me nenin 49 paragrafi 2 ndërlidhur me nenin 63, të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Bazuar në rrethanat dhe të gjeturat si me lartë, Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1056/2023

Ardita Perçuku-Shyti

Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prishtinës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.